



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 480/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkim Ademaj në cilësinë e Zyrtarit të lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, për shkak të mbajtjes së tubimit politik të pa paralajmëruar, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Bashkim Ademaj, në cilësinë e Zyrtarit të lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ) dega në Istog, kështu që subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga Bashkim Ademaj, në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), në Istog, në të cilën theksohet se me datën 25.10.2013, duke filluar nga ora 20:00 e deri në orën 21:00, në shtëpinë private të Muhamet Balaj të fshatit Kaliqan, është mbajtur tubim politik i pa lajmëruar i AAK-së, ku kanë marrë pjesë rreth 50 persona, kurse programin e kësaj partie e ka shpalosur Donika Kadaj Bujupi dhe kandidati për asamble komunale Naim Imeraj. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës, raportin policor.

Po ashtu në raportin policor nga rreshteri policor Sylë Mehmetukaj, zyrtar policor për zgjedhje në stacionin policor në Istog, theksohet se me datën 25.10.2013, duke filluar nga ora 20:00 deri në ora 21:00, në shtëpinë private të Muhamet Balaj në fshatin Kaliqan komuna Istogut, është mbajtur tubim politik i pa lajmëruar i AAK-së, ku kanë marrë pjesë rreth 50 persona simpatizant të këtij subjekti politik, dhe programin e kësaj partie e ka shpalosur kandidatja për kryetare të komunës së Istogut Donika Kadaj Bujupi. Tubimi ka përfunduar i qetë dhe pa asnjë incident, thuhet në raportin policor.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 04.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.11.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, në të cilën theksohet se darka që është mbajtur me datë

25.10.2013, në Istog, në fshatin Kaliqan në shtëpinë private të Mehmet Ukaj e jo të të Muhamet Blakaj siç supozohet, ka qenë darkë private e familjarëve të kryetarit të nëndegës së AAK-së në Kaliqan. restorant Guri nuk ka qenë tubim politik por darkë me strukturat e nëndegës së Vrellës, po ashtu AAK deklaroi se Bashkim Ademaj është vëllau i nënkryetarit të Komunës së Istogut Agim Ademaj nga radhët e LDK-së, dhe këtu kemi të bëjmë me keqpërdorim të drejtës së ankesës dhe pretendimet e tij tendencioze kundër degës së AAK-së në Istog.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet ankimore në ankesën e Bashkim Ademaj, në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), në Istog, lidhur me mbajtjen tubimit politik të pa lajmëruar nga subjekti politik AAK, PZAP-i, konstatoi se janë të bazuara, pasi që neni 4.2 i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, lidhur me Fushatën Zgjedhore dhe Njoftimin lidhur me Ngjarjet Politike, theksohet se subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë dhe të mbajë një tubim publik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, duhet që të Zyrtari i Lartë Komunal i Zgjedhjeve i asaj Komune (ZLKZ), të dorëzojë formularin e plotësuar të Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik (FNJMTP), më së voni shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara. Si rrethanë rënduese PZAP, mori se, subjekti politik AAK, shkeljet e natyrës së tillë i ka kryer edhe më parë, që konsiderohet si recidivist, gjë që e bën përgjegjës këtë subjekt politik. Prandaj PZAP, duke u mbështetur në dispozitën ligjore, konstatoi se subjekti politik AAK, nuk e ka njoftuar organin kompetent komunal në këtë rast ZLKZ-në, për mbajtjen e këtij tubimi, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 dhe neni 120.1.c të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 480/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*